Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	**26.10.2023**	**09.11.2023**	**2023/0797**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.10.2023, OE " SFISHTA AUTO HOME " SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0797, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Gani B.Krasniqi B.I," lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Servisimi dhe mirembajtja e automjeteve Peugeot Partner dhe Bipper,veturave Kia Sportage dhe veturave VW Caddy Smart” me nr. të prokurimit: "vetak-23-8336-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POSTA E KOSOVËS SH.A. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratëskontrata publike kornizë-shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 35,000.00 €.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit
Neni 27 Dosja e Tenderit
Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
Neni 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve
Neni 97 i RRPP-se 001/2023

Te nderuar,

Operatori Ekonomik "Sfishta Autohome" shpk – Prishtine, pjesëmarrës ne procedurën e prokurimit me titull: "*Servilizmi dhe mirëmbajtja e automjeteve Perugeot Partner dhe Nipper, veturave Kia Sportage dhe VW Caddy Smart*", me nr prokurimi: *23-8336-2-2-1*, te iniciuar nga AK – Posta e Kosovës sha, me datën 04.10.2023, ka pranuar njoftimin mbi rezultatin e aktivitetit te prokurimit, ku ne te njëjtin njoftim përshkruhet se kompania jone eshtë shpërblyer me kontrate, ndërsa ne letër standarde potencohet se ne si kompani jemi eliminuar me arsyetimin se:

Në dosjen e tenderit përkatësisht te aneksi 1 është paraparë :
Ne rubrikat e çmimit për njësi te pjesët qe nuk janë te automjeti benzinë ose dizel te

3/7

shënohet fjalia "nuk e ka këtë pjesë".
OE për secilin pozicion ka dhënë çmime edhe për ato njësi që nuk e kanë atë lloji pjese si :
Te tabela një (-I) pozicioni me nr. 3, -33,-44
Te tabela dy (-II-) pozicioni me nr.10.
Te tabela tre (-II-) pozicioni me nr.2,-5,-11.

Komisioni i vlerësimit ka verejturë se disa OE për këto pozicione kanë dhënë çmime disa kanë shkruar se nuk e ka ketë pjesë (NA) ,pas kësaj situate Komisioni i vlerësimit ka dal në teren në disa servise që merren me servisimin e automjeteve dhe ka konstatuar se veturat e AK nuk i posedojn pjesët specifikuar në :
Te tabela një (-I) pozicioni me nr. 3, -33,-44
Te tabela dy (-II-) pozicioni me nr.10.
Te tabela tre (-II-) pozicioni me nr.2,-5,-11.

Ne afatin e parapare me nenin 108/A, te LPP-se kemi paraqitur kundërshtimet tona dhe shkeljet ligjore te konsumuara nga AK – Posta e Kosovës sha, përkatësisht komisioni i vlerësimit te ofertave. AK – Posta e Kosoves, aprovon kerkesen tone si pjesërisht te bazuar, megjithatë le ne fuqi vendimin per dhenje te kontrates, rrjedhimisht ne kuptim te nenit 109, te LPP-se parashtrojme kete ankese:

Pretendimet ankimore:

Për ketë procedure te prokurimit, neve si kompani sipas raportit te vlerësimit te ofertave jemi rekomanduar për dhënie te kontratës, rrjedhimisht AK- Posta e Kosovës sha, me datën 20.09.2023, përmes letrës standarde ka kërkuar qe ti paraqesim dëshmitë lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, vërtetimin e ATK-se, Vërtetimin e Gjykatës kompetente dhe sigurimin e tenderit – Origjinal. Kompania jone te njëjtat dëshmi i ka paraqitur dhe i ka prezantuar ne zyrën e prokurimit te Autoritetit kontraktues se bashku me identifikimin financiar.

- **Prove** kërkesa për dëshmitë e përshtatshmëris si dhe deshmit e ngarkuara i gjeni ne e-prokurim.

Për kundër këtij fakti dhe përkundër skadimit te afatit ligjore AK – Posta e Kosovës, me datën 04.10.2023, kompaninë tone tentoni ta eliminoni nga kjo procedure e prokurimit me arsyetim absurd, pse ne si kompani kemi ofruar çmim për secilin pozicion!

- **PROVE** – Letra standarde - kërkesa për dorëzim de dokumenteve te përshtatshmërisë profesionale dhe ofrimi i tyre.

Ne dosje te tenderit tek aneksi 1, AK – Posta e Kosovës, ka përshkruar vërejtjen si me poshtë:

Vërejtjeje-sqarim:

Konform nenit 56 përkatësisht nenit 56.15 të RRUOPP-së , edhe pse kjo kontratë është kontratë kornizë në këtë rast ***nuk vlen pragu apo tavani + - 30%,*** *dhe me rastin e*

4/7

shpenzimit të vlerës së parashikuar kjo kontratë ndërpritet pa marrë parasysh datën e lidhjes së kontratës.

Pra arsyetimi i eliminimit te kompanisë sonë me arsyetimin e dhëne ne letër standarde, përveç se shkele parimet bazike te prokurimit publik , qe kane te bëjnë me mos favorizim – diskriminim, ekonomicitet dhe ruajtje te parës publike, veprimet e AK-se, bien ndesh dhe me përcaktimin se produktet e përshkruara ne paramane dhe parallogaris apo për sasitë nuk vlere pragu apo tavani +-30 %

Ceshtja e çmimeve eshtë e përcaktuar ne nenin 17, qe nga paragrafi 1 deri 12, te Rregullores për prokurim publik 001/2023, parashihen obligimet e AK-se dhe OE-se.

Paragrafi 2, parasheh strukturën e dosjes së tenderit përbëhet nga tri pjesë:

Pjesa A – Procedura e tenderimit

Pjesa B – Draft Kontrata

Pjesa C – Formulari i Tenderit

Konkretisht paragrafi 12 përcakton:
"*Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës.* ***Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë. Veçanërisht, autoriteti kontraktues duhet të ketë parasyshë, kur përgatitet dosja e tenderit, që mos të ketë komunikime, diskutime ose negocime në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve....*".

Arsyetimi tjetër se "Komisioni i vlerësimit ka vërejtur se disa OE për këto pozicione kanë dhënë çmime disa kanë shkruar se nuk e ka ketë pjesë (NA) ,pas kësaj situate Komisioni i vlerësimit ka dal në teren në disa servise që merren me servisimin e automjeteve dhe ka konstatuar se veturat e AK nuk i posedojnë pjesët specifikuar në disa pozicione".

Kjo qeshje ka qene dashur te trajtohet apo edhe te dilet ne teren para publikimit te njoftimit për kontrate dhe para krijimit te listës – pozicioneve te paramases.

Qeshja e pozicioneve qe nuk ekzistojnë OE te nuk mund te mos japin përshkrim apo te përshkruaj NA. Kjo metode e tentimit te eliminimit te një oferte nuk ka ndodhur asnjëherë ne histori te Prokurimit Publik, madje vet AK Posta e Kosovës, përmes procedurave tjera te prokurimit ka eliminuar oferta ne te cilat nuk eshtë ofruar çmim, madje edhe ne rastet kur eshtë ofruar çmimi për njësi por jo edhe totali për sasi.

Këto shkelje te ligjit te parimeve dhe tentimin për keqpërdorim te parës publike OSHP, do duhej ti raportonte edhe ne KRPP dhe te ndërmerrej masa ligjore ndaje zyrtarit përgjegjës te prokurimit, siç përcaktohet me nenin 25, par 8 te LPP-se.

Kontrata eshtë kornizë ka te beje me mirëmbajtje te automjeteve dhe se tek specifikacionet teknike AK, ka përcaktuar qe pozicionet dhe sasia do te konsumohet varësisht nga kërkesa dhe nevoja e AK-se, por askund nuk ka përcaktuar qe OE-te per pozicione te caktuara te mos japin çmimi. Përkundrazi pjesa C formulari i dorëzimit te tenderit dhe paramana janë pjesët kryesore te procedurës se prokurimit.

Nuk ekziston si pozicion, nuk konsumohet.
Kjo qeshje eshtë e përcaktuar nga vet ju si AK tek aneksi 1 i dosjes se tenderit, kemi te bëjmë me kontratë kornize me çmim për njësi ku nuk dihet konsumi apo edhe pozicioni por ligjërisht ofertuesit janë te obliguar ta plotësojnë çdo pozicion te paramases dhe parallogarise, meçe ekziston përshkrimi i produktit dhe çmimi për njësi.

- Shiko nenin 59 te LPP-se, çmimi për njësi eshtë mbizotërues.

Për me tepër AK – Posta e Kosovës sha, me letrën standarde dhe me arsyetimin e eliminimit ka shkelur edhe nenin 52.3 dhe 56.3. te LPP-se, dhe ka tejkaluar kërkesat e përcaktuara ne dosje te tenderit dhe njoftimit për kontrate.

- Neni 56.3 përcakton:

"*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata,* ***nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit***".

- PROVE – Paramasa dhe parallogaris e krijuar nga ju si AK si dhe ofertat e OE tjerë.

AK – Posta e Kosovës dhe zyra e prokurimit te saje çuditërisht shkeljet ligjore dhe ofertat e pa përgjegjshme i kualifikojnë si te përgjegjshme madje edhe i rekomandojnë për dhënie te kontratës duke dëmtuar edhe buxhetin e vet AK-se, ndërsa ofertën tone e klasifikojnë si oferte te pa përgjegjshme.

Te gjitha këto prova dhe shkresa te prezantuara si me larte argumentojnë se ju si AK – Posta e Kosovës, keni konsumuar shkelje ligjore keni shkelur parimet e prokurimit publik dhe këto veprime – mosveprime janë te sanksionuara me nenin 97, te Rregullores për Prokurim publik, nr 001/2023, rrjedhimisht kërkojmë qe paneli shqyrtues te nxjerri ketë:

V E N D I M

Te aprovohet ankesa jone ne tërësi si e bazuar
Te kthehet lënda ne ri vlerësim

Si përfundim kërkojmë qe eksperti shqyrtues i autorizuar te ketë parasysh gjendjen faktike dispozitat ligjore dhe ne kuptim te nenit 113 te LPP-se, ti trajtoj pretendimet tona ankimore ne atë mënyre qe paneli shqyrtues përmes vendimit përveç qe ta obligoi AK-ne qe ti korrigjoi shkeljet ligjore ta njoftoi edhe KRPP-se, lidhur me favorizimin, diskriminimin qe eshtë aplikuar ne ketë procedurë te prokurimit te argumentuar si me larte.

Ne te kundërtën ne si kompani jemi te detyruar qe realizimin e te drejtave te garantuara me ligje dhe shkeljet e konfirmuara me dispozita ligjore se bashku me prova shkresore ti raportojmë ne OSHP, KRPP e gjetiu.

KRITERET PËR VLERËSIM

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Sqarim:

1.Në çmimin për njësi duhet të parashihet edhe çmimi për orë/pune (furnizimi, çmontimi, montim, riparimi etj).

2.Pozicionin " Pune dore per riparime mekanike dhe elektrike" me kete pozicion nenkuptojmë qe vetem pjeset mekanike dhe elektrike te cilat riparohen dhe nuk ndrrohen

Ndersa per pjeset te cilat ndrrohen çmimi per pune dore duhet te llogaritet ne njesi

3.Operatori ekonomik është i obliguar që në rastin e pranimit të automjetit të bëjë diagnostifikimin dhe të paraqes raport se çka duhet me intervenu. Diagnostifikimin e defektit OE duhet ta beje pa çmim shtesë

4.Ne rubrikat e çmimit per njesi te pjeset qe nuk jane te automjeti benzinë ose dizel te shenohet fjalia "nuk e ka këtë pjesë".

Përshkrim i çmimeve-paramasa

1	Servisimi dhe mirembajtja e automjeteve Peugeot Partner,Bipper,veturave Kia Sportage dhe veturave VW Caddy Smart me numer te prokurimit:vetak-23-8336-221 dhe numer te brendshem:PK-23-48-221													
2	Tabela - I –Niveli I- Vlera 70%													
3	Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Peugeot Partner 1.6 viti i prodhimit 2013 (çmimi x 70%)		Peugeot Bipper 1.4 viti i prodhimit 2013 (çmimi x 70%)		KIA Sportage 2.0 viti i prodhimit 2013 (çmimi x 70%)		VW Caddy 1968cm3 viti i prodhimit 2005		Smart 599cm3 I vitit te prodhimit 2002	
4		Emertimi I Pjesës			Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi i peshuar	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi i peshuar	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi i peshuar	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi i peshuar	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi i peshuar
5	1	Vaj motori (sipas rekomandimit te prodhuesit)	Liter	1		.		.		.		.		.
6	2	Filter Vaji	cope	1		.		.		.		.		.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr:	Grupi:		
1	Servisimi dhe mirembajtja e automjeteve Peugeot Partner dhe Bipper,veturave Kia Sportage dhe veturave VW Caddy Smart		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	Gani B. Krasniqi B.I., 810326307	12000	MIRADI E ULËT

DEKLARATË

[të deklarohet komisioni vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim]

Komisioni i vlerësimit konstaton se OE Gani B Krasniqi i ka plotësuar të gjitha kriteret e parapara me NJK dhe DT. dhe ka ofertuar me çmim ma të lirë nga te gjithë ofertuesit e pergjegjëshëm , me ofertë financiare të poentuar 15,709.75€
andaj komisioni i rekomandon drejtorisë së prokurimit që ta shperblej me kontratë .

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" SFISHTA AUTO HOME " SH.P.K.**

Autoriteti Kontraktues – Posta e Kosovës SH.A gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratëskontrata publike kornizë-shërbim. Vlera e parashikuar e kontratës 35,000.00 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët.**

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër B42 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 04.10.2023. Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, kundrejt pretendimeve ankimore të OE ankues **“Sfishta AutoHome” sh.p.k**, sqarojmë se operatori

ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 24, 27, 51, 52, 53, 59 dhe 108/A të LPP-së, si dhe nenin 97 të Rregullores nr.001/2023 për Prokurim Publik-RRPP.

Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës fillimisht sqaron se AK përmes kërkesës për sqarim të datës 20.09.2023 ka kërkuar nga OE ankues **"Sfishta AutoHome" sh.p.k** qe ti dorëzoj /kompletoj dokumentet si kërkesat e përshtatshmërisë, vërtetimin nga Administrata Tatimore, vërtetimin e Gjykatës dhe Sigurimin e tenderit-origjinal. Po ashtu, në këtë shkresë ceket se këto dokumente janë obligative të dorëzohen nga tenderuesi i cili do të **shpërblehet me kontratë, dokumentet dorëzohen pranë AK-së para njoftimit mbi vendimin e AK-së.** OE ankues me të njëjtën datë ju ka përgjigj kërkesës së AK-së duke i ka bashkëngjit në platformën e-prokurimit dokumentet e kërkuara.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se sipas raportit të vlerësimi të ofertave jemi rekomanduar për kontratë dhe AK me datën 20.09.2023, përmes letrës standarde ka kërkuar që ti paraqesim dështmitë lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, ju kemi përgjigjur kërkesës së AK-së. Tutje, OE ankues shton se për kundër faktit dhe skadimit të afatit ligjor, AK me datën 04.10.2023, kompaninë e tyre tenton ta eliminon me arsyetim absurd pse ne si kompani kemi ofruar çmime për secilin pozicion! OE ankues është eliminuar me arsyetimin sipas Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar si në vijim:

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye:

Në dosjen e tenderit përkatësisht te Aneksi 1 është paraparë:

Ne rubrikat e çmimit për njësi te pjesët qe nuk janë te automjeti benzinë ose dizel te shënohet fjalia ***"nuk e ka këtë pjesë".***

OE për secilin pozicion ka dhëne çmime edhe për ato njësi që nuk e kanë atë lloji pjese si:

Te tabela një (-I) pozicioni me nr.3,-33,-44

Te tabela dy (-II-) pozicioni me nr.10

Te tabela tre (-II-) pozicioni me nr.2,-5,-11

Komisioni i vlerësimit ka vërejture se disa OE për këto pozicione kanë dhënë çmime disa kanë shkruar se nuk e ka këtë pjesë (NA), pasi kësaj situate Komisioni i vlerësimit ka dal në teren në disa servise qe merren me servisimin e automjeteve dhe ka konstatuar se veturat e AK nuk i posedojnë pjesët specifike në:

Te tabela një (-I) pozicioni me nr.3,-33,-44

Te tabela dy (-II-) pozicioni me nr.10

Te tabela tre (-II-) pozicioni me nr.2,-5,-11

Andaj komisioni konstaton se oferta e juaj është në kundërshtim me kushtet e dosjes se tenderit.

Kundër njoftimit B58 Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe arsyetimit të eliminimit, OE ankues paraqet kërkesë për rishqyrtim. AK me datë 10.10.2023 nëpërmjet vendimit aprovon si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe len në fuqi njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues-Posta e Kosovës sh.a.

OE ankues potencon se në dosjen e tenderit tek Aneksi 1, AK-ka përshkruar vërejtjen si me poshtë:Vërejtje-sqarim: Konform nenit 56 përkatësisht nenit 56.15 të RRUOPP-së, edhe pse kjo kontratë është kontratë kornizë në këtë rast nuk vlen pragu apo tavani +/- 30%, dhe me rastin e shpenzimit të vlerës së parashikuar kjo kontratë ndërpritet pa marrë parasysh datën e lidhjes së kontratës. Me tej, OE ankues shton se arsyetimi i eliminimit të tyre me arsyetimin e dhënë në letrën standarde, përveç se shkelin parimet bazike të prokurimit publik që kanë të bëjnë me mos favorizim, diskriminim, ekonomicitet dhe ruajtje të parasë publike, veprimet e AK-së bien ndesh edhe me përcaktimin se produktet e përshkruara në paramasë dhe parallogari apo për sasitë nuk vlen pragu apo tavani +/-30%.

Ekspertja shqyrtuese pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, shqyrtimit të Aneksit 1 të dosjes së tenderit, ofertës financiare të OE ankues, arsyetimin e eliminimit të OE ankues dhe ofertat tjera pjesëmarrëse në ketë aktivitet të prokurimit, **vlerëson** se AK me rastin e hartimit të dosjes së tenderit, përkatësisht në Aneks 1, në faqe.23, pika 4 ka dhënë këtë sqarim:

Provë: Shkëputur nga Aneksi 1

Sqarim:

1.Në çmimin për njësi duhet të parashihet edhe çmimi për orë/pune (furnizimi, çmontimi, montim, riparimi etj).

2.Pozicionin " Pune dore per riparime mekanike dhe elektrike" me kete pozicion nenkuptojmë qe vetem pjeset mekanike dhe elektrike te cilat riparohen dhe nuk ndrrohen

Ndersa per pjeset te cilat ndrrohen çmimi per pune dore duhet te llogaritet ne njesi

3.Operatori ekonomik është i obliguar që në rastin e pranimit të automjetit të bëjë diagnostifikimin dhe të paraqes raport se çka duhet me intervenu. Diagnostifikimin e defektit OE duhet ta beje pa çmim shtesë

4.Ne rubrikat e çmimit per njesi te pjeset qe nuk jane te automjeti benzinë ose dizel te shenohet fjalia "nuk e ka këtë pjesë".

Kurse, në paramasën të cilën e ka përpiluar AK, është përpiluar lista e njëjtë për të gjitha grupet e veturave të cilat do të servisohen edhe pse në këtë listë (paramasë) ka pozicione (artikuj/produkte) të cilat nuk gjejnë aplikim për veturën respektive/përkatëse.

Provë: Shkëputur nga Përshkrim i çmimeve-paramasa

1	Servisimi dhe mirembajtja e automjeteve Peugeot Partner,Bipper,veturave Kia Sportage dhe veturave VW Caddy Smart me numer te prokurimit:vetak-23-8336-221 dhe numer te brendshem:PK-23-48-221														
2	Tabela - I –Niveli I- Vlera 70%														
3	Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Peugeot Partner 1.6 viti i prodhimit 2013 (çmimi x 70%)		Peugeot Bipper 1.4 viti i prodhimit 2013 (çmimi x 70%)		KIA Sportage 2.0 viti i prodhimit 2013 (çmimi x 70%)		VW Caddy 1968cm3 viti I prodhimit 2005		Smart 599cm3 I vitit te prodhimit 2002		
4		Emertimi I Pjesës			Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi i peshuar	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi i peshuar	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi i peshuar	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi i peshuar	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi i peshuar	
5	1	Vaj motori (sipas rekomandimit te prodhuesit)	Liter	1		-		-		-		-		-	
6	2	Filter Vaji	cope	1		-		-		-		-		-	

Po ashtu, **ekspertja shqyrtuese** sqaron se në paramasë tek përshkrim i çmimeve, AK nuk e ka veçuar se cilat automjete janë me djegie benzinë ose dizel dhe kjo ka shkaktuar paqartësi tek operatoret ekonomik pjesëmarrës gjatë përgatitjes së listës së çmimeve të dhëna në paramasë, pasi që për këtë aktivitet të prokurimit gjithsej kanë ofertuar katër (4) operator ekonomik dhe dy nga pjesëmarrësit, kanë plotësuar ofertën financiarë me çmime për të gjitha pozicionet pavarësisht se a janë benzinë ose dizel, ndërsa dy pjesëmarrës tjerë, në pozicione të veçanta, tek oferta financiarë nuk kanë ofruar çmim (NA) "çmimi nuk aplikohet".

Sa i përket konstatimeve të dhëna nga komisioni i vlerësimit, **ekspertja shqyrtuese** vlerëson se arsyetimi i dhënë për OE ankues në Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar se "*Komisioni i vlerësimit ka vërejture se disa OE për këto pozicione kanë dhënë çmime disa*

kanë shkruar se nuk e ka këtë pjesë (NA), ***pasi kësaj situate Komisioni i vlerësimit ka dal në teren në disa servise qe merren me servisimin e automjeteve dhe ka konstatuar se veturat e AK nuk i posedojnë pjesët specifike në:***

Te tabela një (-I) pozicioni me nr.3,-33,-44

Te tabela dy (-II-) pozicioni me nr.10

Te tabela tre (-II-) pozicioni me nr.2,-5,-11

Andaj komisioni konstaton se oferta e juaj është në kundërshtim me kushtet e dosjes se tenderit.

Ekspertja shqyrtuese vlerëson se ky arsyetim bie ndesh me parimet e prokurimit publik sipas nenit 7 të LPP-së, pastaj bie ndeshme vlerësimin e ofertave sipas nenit 59 të LPP-së, pasi që njësia kërkuese e autoritetit kontraktues, është dashur që para se ta inicioj këtë aktivitet të prokurim (para publikimit të njoftimit për kontratë) të hulumtonte për produktet/paramasën që do të prokuroj dhe ta dijë saktë për secilën veturë se cilat pjesë/pozicione nuk i posedojnë dhe çfarë pjesësh do ti nevojiten AK-së për vetura, dhe asesi të veprojnë si në rastin konkret, ashtu siç ka potencuar AK se***"Komisioni i vlerësimit ka dal në teren në disa servise qe merren me servisimin e automjeteve dhe ka konstatuar se veturat e AK nuk i posedojnë pjesët specifike".*** Përkundrazi, në asnjë mënyrë nuk i lejohet komisionit të vlerësimit që të bëjë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin duke konstatuar se disa vetura nuk posedojnë pjesë specifike por është dashtë ta di saktë para njoftimit për kontratë se cilat vetura nuk posedoj pjesë specifike. Komisioni i vlerësimit dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit duhet që ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertave ta bëjë konform kërkesave të vendosura në njoftimin për kontratë, dosje të tenderit dhe gjithmonë në bazë të nenit 59 të LPP-së.

Lidhur me pretendimi e OE ankues se këto shkelje të ligjit dhe tentimi për keqpërdorim të parasë publike, OSHP do duhet ta njoftoj dhe KRPP dhe të ndërmerr masa ligjore ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit siç përcakton nenin 25 par 8 i LPP-së, tutje OE ankues potencon se kontrata është kornizë, ka të bëjë me mirëmbajtje të automjeteve dhe se tek specifikacioni teknik AK ka përcaktuar që pozicionet dhe sasia do te konsumohen varësisht nga kërkesat dhe nevojat e AK-së, por askund nuk ka përcaktuar që OE –të për pozicionet e caktuara të mos

japin çmim. Përkundrazi pjesa C formulari i dorëzimit te tenderit dhe paramasa janë pjesë kryesore të procedurës së prokurimit. Nuk ekziston si pozicion nuk konsumohet kjo çështje është përcaktuar nga vet AK tek Aneksi 1 i DT, tutje OE ankues shton se kemi te bëjmë me kontratë kornizë me çmime për njësi, ku nuk dihet konsumi apo edhe pozicioni por ligjërisht ofertuesit janë obligativ ta plotësojnë çdo pozicion të paramasës dhe parallogarisë meqë ekziston përshkrimi i produktit dhe çmimi për njësi.

Lidhur me pretendim e ankuesit se askund nuk ka përcaktuar AK-së, që OE- të për pozicionet e caktuara të mos japin çmim, **Ekspertja shqyrtuese sqaron** se Autoriteti kontraktues është i obliguar që të specifikoj në detaje dhe të mos lerë hapësirë për interpretime apo vlerësime të ndryshme. Ky obligim ligjor buron nga Rregullorja Nr.001_2022 për prokurimin publik, neni 17.12, ku potencohet se ***"Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor,në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë."***

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OSHP do duhet ta njoftoj dhe KRPP dhe të ndërmerr masa ligjore ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit siç përcakton nenin 25 par 8 i LPP-së dhe po ashtu këto shkelje nga ana e AK janë të sanksionuar me nenit 97 të Rregullores për prokurim publik nr. 0001/2023. **Ekspertja shqyrtuese** vlerëson se pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm ashtu siç u dhanë sqarime si më lartë.

Andaj, bazuar në atë që u tha si me lartë, **ekspertja shqyrtuese** propozon që kjo procedurë të prokurimit të anulohet në tërësi pasi që në fazën të cilën gjendet ky aktivitet i prokurimit, nuk mund të këtë trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomik konformnenit 7 të LPP-së **(**për faktin se dy nga operatoret ekonomik kanëofruar çmimin për të gjitha pozicionet, ndërsa dy të tjerë në pozicione të veçanta nuk kanë ofrua çmim (NA) "çmimi nuk aplikohet"*)*. Po ashtu, vlerësoj që nuk mund të bëhet një vlerësim dhe krahasimi i drejt i ofertave konform nenit 59 të LPP-së, pasi që dy operator kanë dhënë çmime në paramasë për të gjithë artikujt, kurse dy operator tjerë nuk kanë dhënë çmime për të gjithë artikujt. Në një rrethanë të tillë, nuk ekziston një standard i cili mund ti trajtonte në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu, propozoj se ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet si e bazuar për arsyet që janë dhanë si më lart, pasi që ky aktivitet i prokurimit do duhet të anulohet për shkak të mos aplikimit të drejtë të dispozitave ligjore të autoritetit kontraktues.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimit për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POSTA E KOSOVËS SH.A**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" SFISHTA AUTO HOME " SH.P.K.**

Majlinda Bedrolli